



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prenjeno / Predato Received / Delivered	04.12.2023	3	viti god year
Organ / Bjesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	7212/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1330/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga:Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1330/2023 të datës 25.10.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga në kundër Vendimit Nr.02/Zyrtarisht-36350 të datës 24.10.2023 të Komisionit të Pranimit në kuadër të Komunës së Deçanit, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 04.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1330/2023 e datës 25.10.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi nr.36350 i datës 24.10.2023 i Komisionit të Pranimit në Komunën e Deçanit.
- III. Anullohet Konkursi me Nr.Reference: RN00011470 i datës 24.04.2023 për emrin e grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm pozita "Zyrtar për Tatimin në Pronë" të shpallur nga Komuna e Deçanit dhe çdo akt tjetër që rrjedh nga ky proces.

IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Deçanit dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Deçanit më datë 24.04.2023 ka shpallur konkursin me Nr. reference: RN00011470 për emrin e grupit Specialit i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "Zyrtar për Tatimin në Pronë", ku afati për aplikim ka qenë nga data 15.05.2023 deri më datë 25.05.2023. Në këtë konkurs kanë aplikuar njëzet (20) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi, ku sipas njoftimit për verifikim paraprak të datës 02.06.2023 këtë verifikim e kanë kaluar tetëmbëdhjetë (18) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi i cili i është nënshtruar fazave të procedurës duke përfshirë testin me shkrim, vlerësimin e jetëshkrimit dhe intervistën me gojë. Pas përfundimit të procedurës, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Drenasit më datë 20.10.2023 ka publikuar njoftimin e rezultateve përfundimtare të vlerësimit ku ankuesi është renditur i dyti me 70.4 pikë.

Ankuesja kundër rezultatit përfundimtar përmes SIMBNJ më datë 23.10.2023 ka parashtruar ankesë për Komisionin e Pranimit, ndërsa Komisioni i Pranimit më datë 24.10.2023 ka nxjerr Vendimin me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesja kundër Vendimit të datës 24.10.2023 të Komisionit të Pranimit, më datë 25.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6684/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Deçanit. Ndërsa Këshillit më datë 02.11.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6684/2023 e datës 25.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve e datës 20.10.2023; Konkursin me Nr. reference: RN00011470 për emrin e grupit Specialit i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën Zyrtar për Tatimin në Pronë; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 02.11.2023; Listën e aplikantëve; Njoftimin për përfshirje në listë të ngushtë i datës 02.06.2023; Vendimin e datës 20.06.2023 për emalimin e komisionit të pranimit; Aplikacionin e ankuesit i datës 23.05.2023, Diplomë me Nr. 2415, Dëshmi e përvojës ë punës e datës 29.06.2022;

Dokument identifikimi, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 10.01.2023; Raportin mjekësor i datës 10.01.2023; Listën e vlerësimit të jetëshkrimit për ankuesin; Njoftimin e datës 06.07.2023 për kandidatët për pjesëmarrje në testin me shkrim; Vendimin e datës 24.10.2023 të Komisionit të Pranimit; Aplikacionin e kandidatit D.C i datës 24.05.2023, Diplomën me Nr. 0107, Certifikatën e datës 19.03.2023, Diplomën e datës 04.09.2013, Certifikatën e datës 13.02.2013, Vendimin e datës 30.03.2023, Dëshmi e përvojës së punës e datës 22.09.2022, Certifikatën Shëndetësore e datës 18.01.2023, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 24.05.2023, Dokument identifikimi, Listën e vlerësimit të jetëshkrimit për kandidatin D.C.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuses, është e bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk ka pasur transparencë në këtë konkurs pasi që është mbivlerësuar kandidati fitues duke më shkelur të drejtët themelore për pranim në shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil si dhe duke u bazuar në nenin 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative"*, do të bëjë shqyrtimin në tersi të procedurës së pranimit për emrin e grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën *"Zyrtar për Tatimin në Pronë"*, të shpallur nga Komuna e Deçanit.

Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës ka gjetur se në bazë të konkursit me Nr.reference: RN00011470 për emrin e grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën *"Zyrtar për Tatimin në Pronë"*, të shpallur me datë 24.04.2023 nga Komuna e Deçanit, kërkesa të përgjithshme formale kanë qenë: *"Arsini i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve, fakulteti: Juridik, Administratë Publike dhe Ekonomik, Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet"*.

Sa i përket mënyrës së shpalljes së konkursit konkretisht kërkesave të përgjithshme formale, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë (në tekstin në vijim ligji i aplikuar) është bërë kategorizimi i pozitave në shërbimin civil siç parashihet me nenin 33 paragrafi 2, i cili përcakton se: *"2. Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë"*, atëherë Kolegji i Këshillit, në vështirim të nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me pozitat e kategorisë

profesionale është përcaktuar se: "1. Klasat përbërëse të kategorisë profesionale dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 1 Profesional 2 Profesional 3".

Nëse i referohemi Shtojcës me Nr.2 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil lidhur me grupet tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm tek fusha e kërkuar e arsimit është përcaktuar: *Arsim i lartë i paspecifikuar*, kështu që në këtë aspekt nuk janë përfillur kriteret e kësaj rregullore për grupin përkatës të pozitive, ndërsa duke marr për bazë kërkesat të përgjithshme formale të konkursit me Nr.reference: RN00011470 për emrin e grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "*Zyrtar për Tatimin në Pronë*", të shpallur nga Komuna e Deçanit kërkesat për arsimimin e kërkuar janë kufizuar vetëm në ato diploma të fituara në Fakultetin Juridik, Administratë Publike dhe Ekonomik, ndërsa me mos respektimin e kriterëve sipas rregullores së lartcekur, u është mohuar e drejta për aplikim kandidatëve që kanë diploma të tjera jashtë këtyre kualifikimeve e të cilat do të ishin adekuate sipas kërkesave në shtojcën me Nr. 2 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Po ashtu marr parasysh faktin se kriteret arsimimit për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, Kolegji i Këshillit, vlerëson se për këtë grup institucioni që shpall procedurën nuk mund të kufizohet vetëm në disa kritere të arsimimit, ngase Rregullorja (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil nuk ka bërë këtë kufizim.

Bazuar në vetë kërkesat të përgjithshme formale të konkursit me Nr.reference: RN00011470 për emrin e grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "*Zyrtar për Tatimin në Pronë*", të shpallur nga Komuna e Deçanit, rezulton se në këtë konkurs nuk është kërkuar ndonjë përgatitje tjetër profesionale apo e ngjashme në raport me ato që janë kërkuar, nga rrjedhë se sipas provave të lëndës, kandidati fitues posedon Diplomë me Nr. 0107 të lëshuar nga "*Universiteti Haxhi Zeka*" në Pejë, me të cilën dëshmohet se ky kandidat ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin e Biznesit duke marr titullin Bachelor i Shkencave Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri.

Kolegji i Këshillit, vë në dijeni Komunën e Deçanit se Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 2015 ka shpallur konkurs për pozitën "*Zyrtar i Qendrës për Pajisje me Dokumente*" në Komunën e Deçanit, me kriteret e arsimimit *Diplomë në Fakultetin Juridik, Ekonomik, Administratë Publike apo Shkenca Politike*, ndërsa kandidati i suksesshëm në këtë procedurë ka pas të përfunduar Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë duke marr titullin Bachelor i Menaxhimit të Turizmit dhe Hotelierisë, si rezultat i kësaj me qëllim të shqyrtimit të drejtë të kriterëve të arsimimit të kërkuar me konkurs në raport me kandidatin e suksesshëm, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka kërkuar informata zyrtare nga Dekani i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës nëse kandidati që ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë duke marr titullin Bachelor i Menaxhimit të Turizmit dhe Hotelierisë mund të konsiderohet se ka përfunduar Fakultetin Ekonomik, ndërsa Dekani i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës përmes Informatës së datës 27.03.2015 ndër të tjera sqaron se Fakulteti Ekonomik ka gjithsej pesë (5) programe ndërsa programi Bachelor i Menaxhimit të Turizmit dhe Hotelierisë është program studimor krejt tjetër, si rrjedhojë mbi këtë sqarim Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka

vendosur sipas Vendimit A 02/106/2015 dhe A.nr.648/2018 ka anuluar këtë procedurë të rekrutimit duke konstatuar se diploma e studimeve në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë me titullin Bachelor i Menaxhimit të Turizmit dhe Hotelerisë nuk hyn në kuadër të programeve të Fakultetit Ekonomik, si rrjedhojë vendimet e Këshillit Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë vërtetuar me Aktgjykimin A.nr.2883/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.697/2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi i datës 24.10.2023 i Komisionit të Pranimit në Komunën e Deçanit, është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe bazën juridike, kështu që i njëjti është në kundërshtim me parimin e pranimit të zyrtarëve publikë të përcaktuar me menin 6 të Ligjit të aplikuar Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Prandaj nga sa u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit ka ardhur në konstatimin se procedura e pranimit sipas konkursit me Nr.reference:RN00011224 për emrin e grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "Zyrtar për Tatimin në Pronë", të shpallur nga Komuna e Deçanit, është zhvilluar në kundërshtim me parimin e pranimit të zyrtarëve publikë të përcaktuar me menin 6 të Ligjit të aplikuar Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që shkeljet e evidentuara si më lartë e bëjnë të pavlefshme këtë procedurë, si rrjedhojë sipas Kolegjit të Këshillit, konstaton se Kryetari i Komunës së Deçanit dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore janë të obliguar që të ndërmarrin të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi si në dispozitiv.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1330/2023, datë 04/12/2023

Avdyt BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Deçanit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Deçanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;